

URDHËR
Nr. 346, datë 31.3.2026

PËR DELEGIM KOMPETENCE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28, 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Për shkak të angazhimeve për të garantuar vijimësinë e veprimtarisë administrative të Ministrisë, delegoj të drejtën e firmës për të gjitha dokumentet dhe aktet që lidhen me procedurat e importeve në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, zëvendësministrit, **z. Fatmir Guri**, për periudhën **1 prill 2026 deri më 30 prill 2026**.

2. Zëvendësministri i përmendur në pikën 1 është i autorizuar të nënshkruajë në emër të ministrit dokumentet që lidhen me importet, si më poshtë:

- Kërkesat dhe miratimet për importe sipas kompetencës së Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;

- Autorizimet, vërtetimet dhe shkresat zyrtare drejtuar institucioneve shtetërore dhe subjekteve private për çështje që lidhen me importet;

- Çdo dokument tjetër administrativ që kërkon firmën e ministrit në fushën e importeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ky delegim është i vlefshëm vetëm për periudhën **1 prill 2026 deri më 30 prill 2026**. Pas kësaj date, e drejta e firmës kthehet te ministri sipas kompetencave të tij të plota ligjore.

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Çështjeve Juridike Administrative, drejtoria përgjegjëse për importet dhe të gjitha strukturat e tjera përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

5. Ky urdhër hartohet në 3 (tri) kopje të njëjta, 1 (një) për arkiv-protokollin, 1 (një) për Qendrën e Botimeve Zyrtare dhe 1 (një) për zëvendësministrin, sipas pikës 1.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla